

## ANEKSI 6

### Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore

1. Fondi për **Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** është një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit rajonal dhe vendor të fatkeqësive natyrore e të tjera.
2. Për vitin 2025, Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore është pjesë e fondit të akorduar në buxhetin e vitit 2025 në programin “Emergjencat Civile”, në Ministrinë e Mbrojtjes.
3. Vlerësimi i projekteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore aplikuese bëhet me vendim të Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, i cili kryesohet nga Drejtori i AKMC - Kryetar dhe ka në përbërje anëtarë nga struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile), anëtarë nga Ministria e Mbrojtjes, anëtar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe anëtarë nga Shoqata për Autonomi Vendore.
4. Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore miraton; specifikimet, rregullat dhe kriteret **për financimin e projekteve në infrastrukturë dhe për blerje pajisjesh për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** si dhe vlerësimin e projekteve.
5. Sekretariati teknik për Fondin e Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore ngrihet pranë AKMC dhe ndihmon punën e Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore.
6. Fondi i Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve tashmë në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Mbrojtjes mund të kërkojë rialokime midis projekteve të Fondit të Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.
7. Thirrjet për aplikim në Fondin Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore për vitin buxhetor 2025, mund të bëhen që në nëntor të vitit paraardhës deri në 31 Janar të vitit korent.
8. Projektet e përzgjedhura nga Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dërgohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave brenda datës 15 Shkurt të vitit korent.
9. Këshilli i Ministrave miraton projektet e reja fituese, si dhe autoritetin kontraktor për zbatimin e projekteve të reja sipas njësive të vetëqeverisjes vendore brenda datës 28 Shkurt të vitit korent.
10. Fondi i Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.
11. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.